



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine - Ministry of Labour and Social Welfare

Prishtinë 23 Shkurt 2021

**Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara nga MPMS
në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare**

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në mbështetjen e kategorive sociale dhe fuqizimin e familjes/individëve në nevojë sociale, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për ofrimin e shërbimeve sociale.

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në ofrimin dhe avancimin e shërbimeve sociale përmes zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve si më poshtë:

- 3.1. Shërbime rezidenciale dhe ditore për mbrojtjen e fëmijëve të abuzuar, keqtrajtuar dhe neglizhuar;*
- 3.2. Shërbime rezidenciale dhe ditore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit;*
- 3.3. Shërbime alternative për fëmijë pa kujdes prindëror dhe këshillime për familjet strehuese, për zbatimin e programit të strehimit familjar;*
- 3.4. Shërbime alternative për mbrojtje të fëmijëve të braktisur dhe mbështetjen e familjeve strehuese për ofrimin e shërbimeve për fëmijë;*
- 3.5. Shërbime rezidenciale për mbrojtje të fëmijëve të braktisur dhe mbështetjen e familjeve strehuese me këshilla profesionale;*

3.6.Shërbime rezidenciale dhe ditore për largimin e fëmijëve nga punët e rënda e të rrezikshme dhe kërkimi i lemoshës;

3.7.Shërbime, rezidenciale, ditore dhe në familje për fëmije dhe të rritur me aftësi të kufizuara;

3.8.Shërbime të rehabilitimit dhe trajtimit për personat me nevoja të veçanta fëmijë dhe të rritur (të verbërit, të shurdhër,tetraplegjike, paraplegjike, me down sindrom, autizem etj)

3.9.Shërbime të mbrojtjes, këshillimeve psiko-sociale për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara.

3.10. Shërbime, rezidenciale, ditore dhe në familje për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare.

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **900,000.00** euro. Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve nga pika **3.1** dhe **3.2** shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një (1) projekt është **30,000** euro, ndërsa shuma maksimale për një (1) projekt është **50,000.00 euro**. Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të përfshira në pikën **3.3** deri **3.10** shuma minimale e mbështetjes për një (1) projekt është **10,000.00 euro**, ndërsa shuma maksimale për një (1) projekt është **30,000.00** euro.

5. Varësisht prej llojit të kategorisë së klientëve, kohëzgjatjes, shtrirjes territoriale dhe ofrimit të shërbimeve projekti mund të financohet nga 70% deri 100% të totalit të kostove të pranueshme të shpenzimeve, por jo më shumë se sa vlera minimale dhe maksimale për një projekt individual të përcaktuar në pikën nr.4 të kësaj thirrje dhe kritreve të përcaktuara në Udhëzuesin për Aplikantët.

6. Aplikantët dhe partnerët potencialë, për pjesën tjetër të kostove mund të sigurojnë bashkëfinancim nga donatorët dhe burimet tjera publike apo burimet vetanake.

7. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 15 Mars 2021.

8. OJQ-të mund të aplikojnë ose të jenë partner ne më së shumti vetëm në një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje.

9. OJQ-të të cilat kanë marrë mbështetja nga thirrjet publike të MPMS-së gjatë vitit 2020, mund të aplikojnë por nuk mund të nënshkruajn kontratë para përmbylljes së projektit, për të cilin kanë marrë mbështetje financiare nga MPMS-ja në vitin 2020.

10. Periudha e zbatimit të projektit është për 6-10 muaj. OJQ mund të përfshihet me se shumti në një(1)projekt dhe të përfshihet në zbatimin e vetëm një (1) fushe prioritare.

11. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara dhe duhet të janë të *licencuara* nga MPMS-ja, ndërsa për OJQ-ët që kanë qenë të licencuara por të cilave ju ka skanduar licenca duhet të dorëzojnë dëshmi se kanë aplikuar për vazhdimin e licencës në departamentin përkatës në kuadër të MPMS.

12. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga llojet e fushës dhe aktivitetete të përfshirë në kuadër të kësaj thirrje publike.

13. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare*.

14. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

15. Propozimet do të dorëzohen në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale*

16. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën; *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Sheshi Miss Edit Durham nr. 46, pranë Hotel Grandit 10 000 Prishtinë, Zyra e Arkivit në MPMS.*

17. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

18. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

19. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, tek z. Ylber Kokollari-Zyrtar në Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjes, duke e kontaktuar përmes e-mailit në adresën; ylber.kokollari@rks-gov.net